



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve e dhëna me nenin 63 të Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ MF-Nr-01/2019, për Themelimin dhe Funksonimin e Komitetit të Auditimit në Sektorin Publik, si dhe vendimit të KQZ-së Nr.1625/2021, të datës 09.06.2021, për Formimin e Komitetit të Auditimit të Bëndshëm, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e mbajtur me datën 11.08.2021, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Statutit të Komitetit të Auditimit të Bëndshëm të KQZ-së

- I. Miratohet Statutit të Komitetit të Auditimit të Bëndshëm të KQZ-së.
- II. Statuti, si në pikën I të këtij vendimi, është pjesë përbërse e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 11.08.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Pristina, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Në pajtim me Nenin 63 të Ligjit nr.03L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Nenin 20 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-021 si dhe me Udhëzimin Administrativ MF-Nr.01/2019 për Themelimin dhe Funksonimin e Komitetit të Auditimit, KQZ me datë 11.08.2021 miraton:

STATUTIN E KOMITETIT TË AUDITIMIT

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Statut, përcaktohet përbërja e Komitetit të Auditimit, mandati, përgjegjësitë, organizimi i takimeve të punës, bashkëpunimi me Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe KQZ-në, raportimi dhe kompensimi për punën e anëtarëve të Komitetit të Auditimit.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë statut kanë kuptimin si në vijim:

- 1.1. **KQZ**- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- 1.2. **Menaxhment**- nënkupton funksionet e larta brenda Institucionit të KQZ-së që kanë përgjegjësi menaxheriale;
- 1.3. **NjAB- Njësia e Auditimit të Brendshëm**''- nënkupton funksionin e auditimit të brendshëm të organizuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.4. **KA**- Komiteti i Auditimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- 1.5. **ZKF**- Zyrtaari Kryesor Financiar;
- 1.6. **UA**- Udhëzim Administrativ;
- 1.7. **AB**-Auditori i Brendshëm;
- 1.8. **.KB**- Kontrolli i Brendshëm;

Neni 3
Themelimi i Komitetit të Auditimit.

Komiteti i Auditimit themelohet me Vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 4
Përbërja e Komitetit të Auditimit

1. Komiteti i Auditimit përbehet nga 5 anëtarë, 2 anëtarë të KQZ-së dhe 3 anëtarë të jashtëm;
2. Anëtarët e Komitetit duhet të kenë njohuri dhe përvojë së paku dy (2) vjeçare në njërin nga fushat: financa, kontabilitet, auditimi të brendshëm, auditim të jashtëm, menaxhim rreziku, legjislacion dhe teknologji informative.

Neni 5
Mandati i Komitetit të Auditimit

1. Mandati i anëtarëve të KQZ-së në Komitetin e Auditimit është i lidhur me mandatin e tyre në KQZ;
2. Mandati i anëtarëve të jashtëm të KA është 3 vjeçar;
3. Anëtarët e Komitetit të Auditimit do të riemërohen edhe vetëm për një mandat tjetër.

Neni 6
Roli dhe Përgjegjësitë e Komitetit të Auditimit

1. Komiteti i Auditimit është organ i pavarur këshillëdhënës. Roli i tij është të ndihmoj KQZ-në në përmirësimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe të mbështetë Njësinë e Auditimit të Brendshëm për të siguruar pavarësinë e saj funksionale dhe për të siguruar që rekomandimet janë trajtuar si duhet nga menaxhmenti;
2. Komiteti i Auditimit është përgjegjës që të:
 - 2.1. Këshillojë KQZ-në për çështjet që kanë të bëjnë me:
 - 2.1.1. themelimin dhe zhvillimin e sistemit të përgjithshme të Kontrollit të brendshëm;
 - 2.1.2. vlerësimin e rreziqeve;
 - 2.1.3. menaxhimin e rrezikut dhe
 - 2.1.4. përshtatshmërinë e burimeve të aktivitetit të auditimit për të realizuar me sukses planin e auditimit.
 - 2.2. Siguron marrëdhënje efektive dhe bashkëpunuese ndërmjet menaxhmentit, ZKF, NjAB dhe Auditorit të Jashtëm;
 - 2.3. Përgatitë Statutin e Komitetit të Auditimit, Statuti nënshkruhet nga KA dhe aprovohet nga KQZ;
 - 2.4. Shqyrton dhe aprovon Planet Strategjike dhe Vjetore të AB , pa pasur kompetenca drejtuese në këto dokumente;
 - 2.5. Mbikëqyrë dhe vlerëson performancën e aktivitetit të auditimit në përmbushjen e planit të miratuar dhe raporteve periodike të NjAB;

- 2.6. Siguron që mashtrimet e mundeshe ose korrupsioni i dyshuar, të identifikuar nga raportet e AB ose të sjellura ndryshe në vëmendjen e Komitetit të Auditimit, të raportohen tek organet kompetente;
- 2.7. Shqyrton raportet përmbledhëse, gjetjet, rekomandimet e AB dhe siguron që ato janë adresuar siç duhet nga menaxhmenti;
- 2.8. Shqyrton raportet e rregullta mbi statusin e zbatimit të planeve të veprimit të miratuara nga menaxhmenti që rezultojnë nga auditimet e mëparshme dhe rekomandimet e auditorit të jashtëm dhe
- 2.9. Shqyrton Pasqyrat Financiare dhe opinionet e raporteve të auditimit të jashtëm.

Neni 7.

Mbledhjet e Komitetit të Auditimit

1. Takimet e Komitetit të Auditimit mbahen së paku katër (4) herë në vit dhe ftohen nga Kryesuesi i Komitetit të Auditimit.
2. Kuorumi plotësohet nëse shumica e anëtarëve të Komitetit të Auditimit marrin pjesë në takim. Në takime diskutohen çështjet siç janë përcaktuar në Shtojcën 1 të UA 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e KA.
3. Në takime mbahen procesverbalet të cilat ruhen 7 vjet në NjAB;
4. KQZ mund të kërkojë të mbajë takime tjera për të diskutuar çështje të caktuara, për të cilat ka nevojë për këshilla nga KA;
5. Kur është e nevojshme KA mund të ftojë edhe zyrtarët dhe personat tjerë me kualifikim adekuat për të marrë pjesë në takimet e KA. ZKF në KQZ dhe Udhëheqësi i NjAB ofrojnë mbështetje për KA, atëherë kur është e nevojshme dhe kur kërkohet nga KA;
6. Udhëheqësi i NjAB merr pjesë në takimet e KA, me përjashtim kur Komiteti diskuton temat që ndërlidhen me performancën e NjAB;
7. NjAB ofron shërbimet e sekretarisë për KA.

Neni 8

Bashkëpunimi me NjAB

1. Komiteti i Auditimit bashkëpunon me KQZ, ZKF dhe NjAB lidhur me rishikimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe rekomandimet e dhëna;
2. Komiteti i Auditimit mund të mbajë takime me akterët e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni ku diskuton për raportet përmbledhëse të AB dhe Auditorit të Jashtëm, raportin vjetor të aktiviteteve të audituara dhe menaxhimin financiar e kontrollin;
3. Pas çdo takimi të realizuar sipas paragrafit 2 të këtij neni, KA raporton te KQZ duke përmbledhur aktivitetet e ndërmarra dhe ofruar këshilla për veprimet e mëtejme;
4. Komiteti i Auditimit ofron qasje të plotë dhe të papenguar në të gjitha raportet e hartuara dhe të mirëmbajtura nga KA, pas kërkesës së autoriteteve publike të ngarkuara me funksione hetuese ose kontrolli.
5. Njësia e Auditimit të Brendshëm të raportoj në baza të rregullta tremujore dhe në mënyrën që e përcakton Komiteti i Auditimit

Neni 9

Raportimi i Komitetit të auditimit

1. Komiteti i Auditimit përgatitë Raportin Vjetor të punës për KQZ-në, në të cilin përfshihet:
 - 1.1. Përbërja e Komitetit të Auditimit, përgjegjësitë dhe realizimi i tyre;
 - 1.2. Përshtatshmëria e mjedisit të KB;
 - 1.3. Përshtatshmëria e sistemit të menaxhimit të rreziqeve dhe rrugët për mënjanimin e tyre;
 - 1.4. Gjendja financiare dhe përshtatshmëria e sistemit të menaxhimit financiar dhe raportues të KQZ-së;
 - 1.5. Pavarësia e NjAB dhe efektiviteti i NjAB;
 - 1.6. Efikasiteti i NjAB për rishikimin e menaxhimit të rrezikut dhe sistemit të KB dhe dhënia e rekomandimeve të vlefshme për menaxhmentin e lartë dhe përmirësimin e tij;
 - 1.7. Përshtatshmëria e ambientit të KB për të siguruar operacione efektive, efikase dhe të ligjshme dhe
 - 1.8. Ndonjë mangësi të madhe të sistemit që rrezikon Organizatën.
2. Raporti i KA duhet të përfshijë të dhëna për përshtatshmërinë punës dhe burimeve të NjAB dhe nuk duhet të përsërisë përmbajtjen e raporteve të AB;
3. Pas secilit takim, KA harton procesverbalin e takimit dhe konkluzionet e arritura ia dorëzon KQZ-së.

Neni 10

Kompensimi për punën e kryer

Kompensimi i anëtarëve të Komitetit të auditimit për punën e bërë bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores së Qeverisë Nr.34/2012, përkatësisht rregullave tjera të veçanta në rast të miratimit të tyre.

Neni 11

Hyrja në fuqi

1. Ky Statut hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga KQZ;
2. Statuti mund të ndryshohet dhe të plotësohet vetëm në bazë të procedurës sipas së cilës edhe është miratuar.

Prishtinë, 11.08.2021

Kreshnik RADOMIQI, Kryesues i KQZ-së

Sami KURTESHI, Kryesues i Komitetit të Auditimit